# REPUBLIKA E SHQIPERISE
# AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

# DOKUMENTAT
# STANDARDE TË PROCEDURËS SË HAPUR
# PUNË.

**Marreveshje kuadër, me një operatorë ekonomike, ku jo të gjithe kushtet janë të përcaktuara.**

**“RIPARIMET E TURBINAVE TË AGREGATEVE NR.1 E NR.3 NË HEC FIERZË DHE TË TURBINAVE TË 5 (PESË) AGREGATEVE NË HEC VAU DEJËS”.**

**NR. REF-70587-09-03-2020**

# I. NJOFTIMI I KONTRATËS

## Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor

### 1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

| | |
|---|---|
| Emri | KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare) |
| Adresa | Blloku "Vasil Shanto" , Tirane |
| Person pergjegjes | E. Kastrati |
| Tel/Fax | +355 42 228 349, +355 42 239 295 |
| E-mail | kastratie@kesh.al |
| Faqja e Internetit | www.kesh.al |

### I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

| | |
|---|---|
| Institucion qëndror ☐ | Institucion i pavarur ☐ |
| Njesi e Qeverisjes Vendore ☐ | Tjetër **X** |

### 1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po ☐ Jo **X**

## Seksioni 2 Objekti i kontratës

### 2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit: NR. REF-70587-09-03-2020.

### 2.2 Lloji i “Kontratave për punë publike”

| | |
|---|---|
| **Realizimi i punëve** **X** | **Projektimi dhe realizimi i punëve** ☐ |

### 2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po **X** Jo ☐

**2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër**

**Me 1 Operator Ekonomik X**

**Me disa operatorë ekonomikë** □

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po X Jo** □

**Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloj Marrëveshje Kuadër.**

| |
|---|
| Bazuar ne nenin 41 dhe neni 43 te VKM-se nr.914 date 29.12.*2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”*, i ndryshuar, në Udhëzimin Nr.06, datë 16.01.2018 “***Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike***” i ndryshuar.<br>Marrëveshja kuadër do të aplikohet me një operator të vetëm ekonomik, me qëllim lidhjen e kontratave të bazuara në këtë marrëveshje, brenda kufijve dhe kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër. Lidhja e marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik është më e përshtatshme duke patur parasysh natyrën e punës, relacionin, preventivat, specifikimet teknike dhe termat e referencës të vendosura në kërkesat e Autoritetit Kontraktor, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, nga ana teknike dhe organizative.<br>Meqenëse konkurimi do të jetë më çmim për njësi, dhe do të zgjidhet si fitues ofertuesi i cili do të ofrojë **shumatoren e çmimeve për njësi** me te ulet. Marrëveshja me një operator mjafton për të përftuar shërbimin më të mirë dhe me çmim më të ulët. |

**2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të përfundojë Marreveshja Kuadër: 1 (një).**
(*Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër*).

| | | |
|---|---|---|
| **2.6** | Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike. | Nuk do të ketë rihapje të konkursit.<br>Kontratat do të lidhen sipas kerkesave te AK, me operatorin ekonomik me te suksesshëm, i cili do te ofroje **shumatoren e çmimeve për njësi** me te ulet.<br>Dhënia e kontratave do të behet nga KESH sh.a.<br>Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatori ekonomik, palë në marrëveshje, ku do ti percaktohet relacioni teknik dhe preventivat e |

| | | |
|---|---|---|
| | | punimeve qe do te kryhen per secilin objekt.<br>Ne rast te lindjes se nevojes konkrete per te lidhur nje kontrate brenda marrëveshjes kuader, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasitë përkatëse te punimeve.<br>Autoriteti kontraktor i kerkon operatorit ekonomik, fitues te japë oferten e tij.<br>Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet ne forme te shkruar, ose elektronike (e mail, fax, etj.) dhe ne çdo rast duhet te dokumentohet dhe te behet pjese e dosjes se procedures.<br>Sasitë e parashikuara dhe të kerkuara ne preventiv janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato.<br>Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë më pak apo më shumë punë se sa ato te parashikuara ne preventiv (por ne cdo rast brenda vleres se perllogaritur te marreveshjes kuader).<br>Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t’i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të kryejë më pak apo më shumë pune se sa ato të specifikuara ne preventiv dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos kryejë asnjë nga këto pune sipas preventivit te punimeve.<br>Çmimet për njësi janë percaktuar në Formularin e Cmimit të Ofertës.<br>Çmimet e njësive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t’i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër. |

**2.7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër:**

**KESH.Sh.a.**

**2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër**

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës për 3 vjet : 150,969,500 (Njëqind e pesëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.
2. **Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj,** shumatorja e çmimeve **për njësi është : Hec Fierzë 1,013,873** (Një milion e trembëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre) **Lekë pa TVSH dhe Hec Vau Dejës 884,535** (Tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH.**
3. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e KESH sh.a.
4. Objekti i kontratës /marrëveshjes kuadër**:** "Riparimet e Turbinave të Agregateve Nr.1 e NR.3 në HEC Fierzë dhe të turbinave të 5 (pesë) Agregateve në HEC Vau Dejës".

**2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në **3 (tre) vjet.**
ose
duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

**2.9.1** Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

| |
|---|
| **Kohëzgjatja në muaj: 3 (tre) vjet** *ose* **ditë:** □□□□ **(nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër** *(jo më shumë se (4) vjet*) <br> *Ose* <br> **duke filluar nga** □□/□□/□□ **(dd/mm/vvvv)** <br> **Përfunduar më** □□/□□/□□ **(dd/mm/vvvv)** |

**2.10 Vendndodhja e objektit të kontratës/marrëveshjes kuadër:**

**HEC Fierzë, HEC Vau Dejës.**

**2.11 Ndarja në LOTE:**

Po □ Jo **X**

*Nëse po,*

**2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve**

(Objekti dhe fondi limit i loteve)
1___________________________________________________________________________
2.__________________________________________________________________________
3.__________________________________________________________________________

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë

**2.13 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme *(nëse ka):* □□

Ose: nga □□ në □□

**2.14 Do të pranohen variantet:**

Po □ Jo **X**

**2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi:**

Po □ Jo **X**

**Nese do te lejohet nenkontraktimi,** te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: ____

Autoriteti kontraktor do t’i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po □ Jo **X**

**Shenime te tjera**

_____________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________
__________________________________________________________________________

**Seksioni 3** **<u>Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik</u>**

**3.1 Kriteret e Pranimit** sipas Shtojcës 8.

**3.2 Sigurimi i ofertës[1]** (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 3. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është _________ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës për secilin nga Lotet është si më poshtë:

Loti 1 ______ Lekë
Loti 2 ______ Lekë

**Seksioni 4 Procedura**

**4.1 Lloji i procedurës: E hapur**

Procedurë prokurimi e rishpallur
Po □ Jo **X**

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anulluar ______________________________________________

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimi të anulluar ____________________________

c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anulluar _____________________________________

**4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) **çmimi më i ulët X**

*Ose*

B) □ **oferta ekonomikisht më e favorshme** □

lidhur me rëndësinë: Çmimi □□□ **pikë**
etj. □□ **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

**4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**
Data: **05/10/2020** *(dd/mm/vvvv)* **Ora: 10:00**

[1] Sigurimi i ofertes nuk kërkohet në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar

**Vendi: www.app.gov.al**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al**

**4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**
Data: **05/10/2020** *(dd/mm/vvvv)* **Ora: 10:00**

**Vendi: www.app.gov.al**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 ditë.**

**4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Shqip **X** Anglisht ☐
Tjetër ________________

**Seksioni 5 Informacione plotësuese**

**5.1 Dokumenta me pagesë** *(i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):*

Po ☐ Jo **X**

*Nëse Po*

Monedha __________ Çmimi ________

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **04/09/2020.**

**Njoftimi i kontrates për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor , i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike**

**1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

| | |
|---|---|
| Emri | KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare) |
| Adresa | Blloku "Vasil Shanto" , Tirane |
| Person pergjegjes | E. Kastrati |
| Tel/Fax | +355 42 228 349, +355 42 239 295 |
| E-mail | kastratie@kesh.al |
| Faqja e Internetit | www.kesh.al |

**2. Lloji i procedurës se prokurimit:** “Procedurë e Hapur, Marrëveshje Kuadër”, me mjete elektronike.

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** “Riparimet e Turbinave të Agregateve Nr.1 e NR.3 në HEC Fierzë dhe të turbinave të pesë Agregateve në HEC Vau Dejës”.

**4. Numri i referencës së procedurës/lotit: NR. REF-70587-09-03-2020.**

**5. Fondi limit**: 150,969,500 (Njëqind e pesëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.

**6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin**: **3 (tre) vjet.**

**7- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**
**Data: 05/10/2020 Ora: 10:00.**

**8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**
**Data: 05/10/2020 Ora: 10:00.**

## II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

**Seksioni 1. Hartimi i ofertës**

1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.

1.3 *(opsion)* Do të organizohet një vizitë në kantier në __________ (dd/mm/vv) në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime dhe të cilat do tu shpërndahen të gjithë Operatorëve Ekonomikë. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem kontaktoni: (përcaktoni personin e kontaktit)

1.4 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë qe nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertes duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.

1.5 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit.

1.6 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.

1.7 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formularin e Ofertës (Preventivi), plotësuar sipas Shtojcës 1.

b) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1.

c) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, projekte, etj*)
___________ ,
___________ ,
___________ .

ç) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 12.

d) (opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet )

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Me plotesimin e Shtojcës "Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëniet e Punës„„ operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115, dhe të legjislacionin të punës në tërësi.

1.8 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.

1.9 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetem ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për ekzekutimin e punëve; Nr. e Njoftimit.
**"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv ___________ orës _________".**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.**

1.10 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **"MODIFIKIM OFERTE"** ose **"TËRHEQJE OFERTE".**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund te modifikojë në cdo kohë ofertën deri para afatit kohor përfundimtar për dorëzimin e ofertave pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare te APP-së, www.app.gov.al.**

**Seksioni 2 Përllogaritja e ofertës ekonomike**

2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar punët që do të realizohen, sasitë dhe çmimin e tyre per “kontratat me çelsa në dore” dhe “çmimet fikse” për kontratat e punimeve me matje .

2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH-ne. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në preventiv çmimet për cdo zë punimi dhe çmimin total të ofertës të të gjitha punëve, pa TVSH. Vlera e TVSH-se, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.

2.4 Përveç kur Dokumentat e Tenderit e parashikojnë ndryshe, çmimet e dhëna nga Ofertuesi duhet të jenë të fiksuar përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t’i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktor si e papranueshme.

2.5 Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet nuk janë përcaktuar çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara ato janë objekt i ndryshimit pas një Mini-konkursi në mes të palëve në marreveshjen kuadër.

2.6 Sigurimi i Ofertës kur kërkohet duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

2.7 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare
b ) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet bashkë me oferten para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

2.8 **Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës**

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë nga përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

2.9 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së.

**Seksioni 3. <u>Vlerësimi i Ofertave</u>**

### 3.1 Kriteret e përzgjedhjes

**(Opsioni 1)** Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.
Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

**(Opsioni 2)** Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:
Po= Pk1+Pk2+Pk3+.....

Ku:
Po - jane pikët totale të ofertes së vlerësuar
Pk1/Pk2/Pk3/... - jane pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet
Vmin k1 Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
Pmaxk1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

**Sqarim**: Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

## 3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e pajis njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.3 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, sipas shëmbujve të mëposhtme:
- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,
- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se ± 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

## 3.4 Ofertat anomalisht të ulëta

3.4.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me punët e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.4.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta
$M_O$ – Mesatarja e Ofertave të vlefshme
n – Numri i Ofertave të vlefshme
$Z_M$ – Zbritja e Mundshme

$$\mathbf{M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \ldots O_n / n}$$

$$\mathbf{Z_M = 85\ \%\ Mo}$$

**Vlera e Ofertës që vlerësohet <..ZM.........., si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët**

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

**3.5.** Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

## Seksioni 4. Nënshkrimi i Kontratës

### 4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 16. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

### 4.2 Sigurimi i kontratës

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të

Kontratës, sipas Shtojcës 20 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

4.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare,
b)garanci sigurimi.

**Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore ne rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.**

**4.2.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar**

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

**Shënim:** Autoritetet kontraktore nuk duhet të nderhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

## III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
Shtojca 1/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur
Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë në rastin e marrëveshjes kuadër
Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial
Shtojca 5: Deklarate mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik
Shtojca 6: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër
Shtojca 7: Deklarata mbi konfliktin e interesit
Shtojca 8: Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve Të Përgjithshme per Kualifikim
Shtojca 8/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës
Shtojca 9: Formular vleresimi
Shtojca 10: Deklarata e disponueshmërisë së makinerive
Shtojca 11:Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces
Shtojca 12: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
Shtojca 13: Projekt-zbatimi dhe specifikimet teknike
Shtojca 14: Preventivat
Shtojca 15: Formulari për Njoftimin S'kualifikimit
Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Fituesit
Shtojca17:Formulari i Njoftimit të Fituesit për operatorët ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër
Shtojca 18: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
Shtojca 19: Kushtet e Vecanta të Kontratës
Shtojca 20: Formulari i Sigurimit të Kontratës
Shtojca 21: Formulari i Ankesës ne Autoritetin Kontraktor
Shtojca 22: Draft Marreveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 23: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 24: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar
Shtojca 25: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike
Shtojca 26: Formulari i Njoftimit të Anullimit

**Shtojca 1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]*

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Emri i Ofertuesit______________________

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; me TVSH

| **Nr** | **Nr. Analizë** | **Përshkrimi i Punëve** | **Njësi** | **Sasia** | **Çmimi/ Njësi** | **Cmimi total** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | | | | | | |
| 2. | | | | | | |
| 3. | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| **Shuma** | | | | | | |
| **Fondi Rezervë** | | | | | | |
| **Shuma** | | | | | | |
| **TVSH** | | | | | | |
| **SHUMA TOTAL** | | | | | | |

Nënshkrimi i ofertuesit ____________________________
Vula
Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

***<u>Shënim:</u>***

***Formulari i ofertes duhet te plotesohet sipas tabelave bashkelidhur ku jane percaktuar preventivat e punimeve te vecanta per HEC Fierze dhe HEC Vau Dejes.***

- Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë të dyja tabelat e mësipërme, tabelën nr.1 për vlerën totale të ofertës sipas Shtojcës 1 dhe tabelën nr.2 për shumatoren e çmimeve për njësi, per secilin ze.

- Mbështetur në Udhëzimin Nr.15, datë 26.11.2018 *"Për një ndryshim në udhëzimin Nr.6, datë 26.11.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"*, duke qenë se objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me çmim për njësi.

- **Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për totalin e mjeteve.**

**Shtojca 1/1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]*

**DEKLARATË**

**Për paraqitje Oferte të Pavarur**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë:_________________; nga Autoriteti Kontraktor: ___________________; me objekt: ______________________; me fond limit: ___________________.

Unë i nënshkruari ______________________, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik___________________, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të:___________________________që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës,është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

   a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
   b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

   a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; ☐

   b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). ☐

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

   a) çmimet ;
   b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
   c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
   d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

______________________________________________________

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

______________            ___________________

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

**Shtojca 2**
[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]*

**FTESA PËR OFERTË**

(*shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor*)
fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Punëve të mëposhtme:
…………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………
*(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratë dhe sasive siç përkufizohet në Dokumentacionit të Tenderit (DT)).*

<u>Vendi i kryerjes së punës</u>
*(jepni një përshkrim te shkurtër)*

Afati i punimeve ____________

Oferta duhet të paraqitet
…………………………………………………………………………………………………
[*Jep adresën e saktë*]

Përpara
………………………………………………………………………………………………
[*Përcaktoni datën dhe orën*]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese ________________________________________

Forma e komunikimit:

Me shkrim ☐ elektronike (email, fax, etj) ☐

**Shtojca 3**

[*Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _______]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-së*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit perfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

  Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotesuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*]. [Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca 4**

## LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**KUJDES**

Çdo e dhënë, që nuk është regjstruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5**
[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

## DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë ________________ nga Autoriteti Kontraktor ____________ me objekt ________________me fond limit ___________

Unë i nënshkruari ____________________me cilësinë ____________të operatorit ekonomik _____________________ deklaroj se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

**Data e dorëzimit të deklaratës ______________**

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 6**
[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I**
**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

| ☐ **Punë:**<br>Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____ | | |
|---|---|---|
| **Kontrata Nr.** | **Titulli i Kontratës** | **Përshkrim i shkurtër i kontratës** |
| **01** | __________ | _______________ |
| **02** | __________ | _______________ |
| **03** | __________ | _______________ |
| **…** | __________ | _______________ |

**Shtojca 7**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë ___________________ nga Autoriteti Kontraktor_________________ me objekt _____________ me fond limit ___________.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat,Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut,

ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari ______________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik ________________deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**______________________________**

Vula

**Shtojca 8**

**[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]**

## DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ____________________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari ___________________me cilesinë ___________të operatorit ekonomik ____________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _______________________ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

- Operatori ekonomik _____________________ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik,*** si më poshtë:

  ______________________
  ______________________
  ______________________etj.

  nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP[2].

- Operatori ekonomik _____________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik _____________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

[2] Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

- Operatori ekonomik ____________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**

**Nënshkrimi i ofertuesit ______________**

**Vula ______________**

**Shtojca 8/1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në proçedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt _______________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilësinë e ___________të operatorit ekonomik __________________, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**
**Përfaqësuesi i ofertuesit**
**Nënshkrimi**
**Vula**

## Shtojca 9

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

**FORMULAR VLERËSIMI**

**( Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)**

| | |
|---|---|
| Autoriteti kontraktor/Investitori | |
| Adresa/Tel. | |
| Emri i Titullarit/Administratorit | |
| **VËRTETOJ SE:** | |
| Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me | |
| Emri i operatorit NIPT/<br><br>Bashkimit të operatorëve NIPTET/<br><br>Nënkontraktoret NIPTET | |
| Adresa/t | |
| Objekti i kontratës: | |
| Data e fillimit të kontratës | Data e mbarimit të kontratës |
| Vlera sipas kontratës | Vlera e realizuar |
| % e bashkimit te O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar<br><br>Nënkontraktoret. | |
| Vlerësimi | (shprehur me fjalë) |
| | E përmbushur<br><br>E papërmbushur |
| **Firma** | |
| **Vula e Autoritetit Kontraktor** | |

**Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE**

Operatori ekonomik:_________________________

**Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:__________________________________________________**

| Në pronësi | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa** | **Nr. Lejes qarkullimit** | **Nr. Shasisë** | **Të tjera** |
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |
| 5 | | | | |

Dhe

| **Me qera** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa e mjetit** | **Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit** | **Nr. Shasisë së mjetit** | **Nr. Kont së qerasë (noterisë)** | **Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)** |
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |
| 6 | | | | | |

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**
**Emri:**
**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**
**Faks:**
**E-mail:**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 11**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)*

## DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES[3]

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë ________________ nga Autoriteti Kontraktor ____________ me objekt ____________________me fond limit ___________.

Unë i nënshkruari ___________________me cilësinë ____________të operatorit ekonomik ____________________ deklaroj se kam në proçes dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

| Nr. | Autoriteti kontraktor | Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës | Vlera e shpallur fituese |
|---|---|---|---|
| | | | |

**Data e dorëzimit të deklaratës ______________**

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë

[3] Kjo deklarate ka si qellim plotesimin e kriterit ligjor qe operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

**Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

**a.** Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

**b.** Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
*c. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
*d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
*dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 8/1;*
***e**. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

### 2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018, 2019 me një vlerë jo me e vogel se 75,000,000 (Shtatë dhjetë e pese milion) Lekë.

*Për të vërtetuar plotesimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit .*

**2.2.2** Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv (të mos ketë dalë me humbje) të qendruëshem gjatë tre viteve 2017, 2018 dhe 2019. Për të vërtetuar plotesimin e këtij kushti. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve te fundit , të paraqitur pranë autoritetit përkatës, ***të shoqëruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabël i autorizuar (akt ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel i autorizuar, do ta paraqesin të gjithë operatorët ekonomik që janë objekt i nenit 41, gërma “c” të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009).***

## 2.3 Per kapacitetin teknik:

__2.3.1__ Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo me te vogel se 75,000,000 (Shtatë dhjetë e pese milion) Lekë, realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së tenderit,

**Ose**

Punë të ngjashme ku vlera totale e punëve të marra së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes se tenderit të jetë jo me e vogel se 290,000,000 (Dyqind e nentedhjetë milion) lekë.

**Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.**

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë punët sipas tabelës së mëposhtme:

| NR | OBJEKTI I KONTRATES | DATA E FILLIMIT | DATA E PERFUNDIMIT | VLERA PA TVSH | VLERA E REALIZUAR NE 3 VITET E FUNDIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

**__Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e kontratave të ngjashme, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :__**

- Për kontrata për punë publike të realizuara me institucione shtetërore kërkohen:
  - Kontraten/at e Sipërmarrjes,
  - Situacion përfundimtare të objektit,
  - Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojces nr.8,
  - Akt Kolaudimi,
  - Çertifikaten e marrjes ne dorezim.
- Për kontrata për punë publike të realizuara me subjekte private kërkohen :
  - Kontraten/at e Sipërmarrjes,
  - Situacion përfundimtare të objektit,
  - Faturat tatimore për çdo situacion,
  - Formular Vleresimi nga Investitori,
  - Akti i Kolaudimit,
  - Çertifikaten e marrjes ne dorezim.

**2.3.2** Ofertuesi duhet te kete pjese të stafit teknik, inxhinieret dhe tekniket e mëposhtëm:

- Jo më pak se 2 (Dy) Inxhiniere Mekanike. Per permbushjen e ketij kriteri duhet te paraqiten diplomat, kontratat e punës dhe CV.
- Jo më pak se 4 (Katër) Axhustatore. Per permbushjen e ketij kriteri duhet te paraqiten kontratat e punës si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të lëshuara nga institucionet e autorizuara me ligj.

- Jo më pak se 2 (Dy) Saldatore, nga të cilët njëri të jetë i certifikuar me EN ISO 9606-1, 141/111 TUBE BW FM 5 141:S 111:B. Per permbushjen e ketij kriteri duhet te paraqiten certifikatat përkatëse, kontratat e punës.

*Për sa me sipër të paraqitet vertetim leshuar nga Administrata Tatimore per periudhen 3 muajt e fundit Qershor - Gusht 2020 shoqeruar me formularet e listepagesave E-SIG-25 (Nga sistemi elektronik i tatimeve.)*

**2.3.3.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO **ose ekuivalentin e tyre** si më poshtë:

**1)** ISO 9001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ;
**2)** ISO 14001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
**3)** ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë në punë”;

***Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, dhe të jenë në përputhje me nenin 30 të V.K.M. Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.***

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e kontrates, duhet të disponojë këto paisje dhe makineri:

| **Emri i Mjetit** | **Njesi** | **Sasi** | **Statusi** |
|---|---|---|---|
| Paisje speciale për prerje me elektroda karboni | cope | 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Furrë tharje për elektroda | cope | 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Paisje saldimi për elektroda inoksi | cope | 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Paisje axhustimi në përmasa të vogla | cope | 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Paisje për shpimin në lopatat e rrotës së punës | cope | 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Kamionçin vinç 1-1.5 ton | cope | 1 | Ne pronesi ose me qera |

a) Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje e noteruar. Makinerite dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik. Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet të jetë e shtrirë në një kohë përtej afatit të përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.

b) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar.
c) Makineritë e mësiperme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa ”a” te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.**

**Në respektim të nenit 23 te LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalent”.**

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Shtojca 13**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga  autoriteti kontraktor)*

**PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Terma reference dhe specifikime teknike**

**Mbi punimet ne rrotat e punes se agregateve Nr.1 dhe Nr.3 HEC Fierzë dhe te tek rrotat e punës dhe tubacionet e prishsave te vakumit ne pese agregatet ne  HEC Vau i Dejes.**

**Kërkesa të përgjithshme**

- Kontraktori duhet të shqyrtojë relacionin teknik, preventivin e punimeve dhe menyren e realizimit te punimeve që përpara lidhjes së kontratës me Investitorin.
- Kontraktori do te jete pergjegjes per  kontrollin dhe duhet te verifikojë informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjgjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget dhe ne mosperputhje me gjendjen aktuale ne objekt.
- Kontraktori do të inspektojë në objekt shkallen e demtimeve ne rroten e punes, aparatin drejtues dhe të përcaktojë, volumin e punimeve dhe të saktesoje mënyrën e realizimit të të gjitha proceseve te punes
- Kontraktori duhet te jape asistencen e tij teknike tek punedhenesi pas kontrollit te kryar ne rroten e punes dhe aparatin drejtues dhe te percaktojë qarte menyren e realizimit te detyres.
- Kontraktori gjate te gjithe fazes se zbatimit te punimeve duhet te beje ne menyre periodike dhe te vazhdueshme, konsulta me personelin inxh-teknik te objektit, te dokumentojë dhe fotografafojë te te gjithe proceset e punes sipas udhezimeve te supervizorit ne menyre qe te demostroje progresin e punes, cilesine e materialeve te perdorura dhe punimeve te kryera, kushtet e punes, etj.

**Specifikime teknike**

- Te gjitha dokumentat teknike qe shoqerojne keto punime do te jene baze per vleresimin e sasise dhe cilesise se punes qe do te behet per zbatimin e tyre.
- Kontraktori do te marre persiper te gjithe pergjesine ne kryerjen e llogaritjeve per sasine dhe llojet e materialeve, volumeve te punes si dhe pajisjeve te kerkuara per kryerjen e kesaj pune.

- Çdo ndryshim apo pershtatje me kushtet aktuale do te behet vetem ne bashkepunim me grupin teknik, supervizorin e punimeve dhe me aprovim te Investitorit.
- Kontraktori gjate realizimit te saldimeve, prerjeve dhe proceseve te tjera do te mbeshtetet dhe do te respektoi standardet IEC dhe ISO.
- Kontraktori ne fund te çdo operacioni pune si çarje kanali, saldimi do te beje kontroll me penetrant dhe pasi te bindet se nuk ka probleme te vazhdoi ne proceset e tjera.
- Materialet dhe pajisjet qe do te perdoren gjate kryerjes se punimeve duhet te vijne te shoqeruar me certifikate cilesie dhe orgjine te prodhimit te mallit.
- Materialet dhe pajisjet qe do te perdoren duhet te perputhen me standartet nderkombetare te cilesise, kohezgjatjes dhe duhet gjithashtu te jene te tilla qe ti rezistojne veprimeve mekanike, gerryese, termike dhe lageshtires.
- Ne fund te proceseve te pune do te behet kontrolli me penetrant i te gjithe rrotes se pune, aparatit drejtues dhe zonave te tjera bojekt kontrate.

**<u>Puna përgatitore dhe inspektimet</u>**

- Perpara se te kryhen proceset e punes se kerkuar ne ambientet e brendshme, zona duhet te jete e pastruar dhe sipas rregullave te sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune.
- Asnje proces pune nuk duhet te kryhet derisa Mbikqyresi i punimeve te kete inspektuar dhe aprovuar masat e duhura per fillimin e punes sipas kushteve teknike te dhena me siper .

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

**PREVENTIVI I PUNIMEVE RIPARIMI I DËMTIMEVE NË RROTËN E PUNËS, APARATIN DREJTUES TEK AGREGATET NR.1 DHE NR.3 NË HIDROCENTRALIN E FIERZËS.**

| NR. | NR. ANALIZE | PËRSHKRIMI I PUNËVE | NJËSIA | SASIA E E PRITSHME | ÇMIMI NJESI | ÇMIMI TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **PUNIME PËRGATITORE** | | | | | |
| 1 | | Ndërtimi i skele druri poshtë, kompletimi me shkallë dhe mjete mbrojtëse | m² | 16.61 | | |
| 2 | | Transporti në galeri në kuotë 156 m të pajisjeve dhe veglave të punës. Instalimi i panelit të ushqimit dhe instalimi i pajisjeve të saldimit në galeri. Instalimi i pajisjeve të furnizimit me ajër, furrës tharëse dhe pajisjeve të axhustimit në platformë. Kompletimi me ndriçim i dhomës spirale, platformës dhe bankoportave hyrëse. Marrja e masave të sigurimit teknik në dhomën spirale, rrotën e punës dhe tubin thithës | njësi | 2 | | |
| | **PUNIME TEK LOPATAT E RROTËS SË PUNËS** | | | | | |
| 1 | | Kontrolli me penetrant për përcaktimin e përmasave të çarjes dhe dëmtimeve tek lopatat e rrotës së punës | njësi | 10 | | |
| 2 | | Shpimi i vrimave kufizuese të çarjeve tek secila lopatë | njësi | 20 | | |
| 3 | | Realizimi i kanaleve në zonat e çara për realizimin e saldimit duke bërë kontroll me penetrat | njësi | 20 | | |
| 4 | | Axhustimi i kanaleve, kontrolli me penetrat dhe përgatitja për saldim | njësi | 20 | | |
| 5 | | Realizimi i proçesit të saldimit dhe kontrolli në mënyrë të vazhduar me penetrant | njësi | 20 | | |
| 6 | | Axhustimi i zonave të salduara dhe realizimi i profilit gjeometrik | njësi | 20 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **PUNIME NË ZONAT E KAVITUARA NË MES LOPATAVE NË UNAZËN E SIPËRME** | | | | | | |
| 1 | | Përcaktimi me matje i përmasave të kavituara tek secila lopatë | njësi | 32 | | | |
| 2 | | Pastrimi me elektroda karboni i zonave të dëmtuara duke bërë kontroll me penetrat | njësi | 32 | | | |
| 3 | | Axhustimi i zonave të pastruara dhe përgatitja për saldim | njësi | 32 | | | |
| 4 | | Realizimi i proçesit të saldimit duke bërë kontroll me penetrat | njësi | 32 | | | |
| 5 | | Axhustimi i sipërfaqeve të salduara dhe realizimi i profilit gjeometrik të sipërfaqeve | njësi | 32 | | | |
| | **PUNIME NË ZONAT E HYRJES DHE DALJES SË LOPATAVE TEK UNAZA E POSHTME** | | | | | | |
| 1 | | Përcaktimi me matje i përmasave të kavituara tek secila lopatë | njësi | 22 | | | |
| 2 | | Pastrimi me elektroda karboni i zonave të dëmtuara duke bere kontroll me penetrat | njësi | 22 | | | |
| 3 | | Axhustimi i zonave të pastruara dhe pergatitja për saldim | njësi | 22 | | | |
| 4 | | Realizimi i proçesit të saldimit duke bërë kontroll me penetrat | njësi | 22 | | | |
| 5 | | Axhustimi i sipërfaqeve te salduara dhe realizimi i profilit gjeometrik të sipërfaqeve | njësi | 22 | | | |
| | **PUNIME NË ZONAT E KAVITUARA NË UNAZËN E POSHTME TEK APARATI DREJTUES** | | | | | | |
| 1 | | Demontimi i sektorëve unazor mbajtës të gominave | njësi | 20 | | | |
| 2 | | Matja dhe përcaktimi i përmasave të kavituara në unazën e poshtme | njësi | 24 | | | |
| 3 | | Pastrimi i zonave të dëmtuara dhe kontrolli me penetrat | njësi | 24 | | | |
| 4 | | Axhustimi i zonave deri në sipërfaqe të pastër dhe kontrolli me penetrat | njësi | 24 | | | |
| 5 | | Realizimi i proçesit të saldimit dhe kontrolli me penetrat | njësi | 24 | | | |
| 6 | | Axhustimi i sipërfaqeve të salduara dhe realizimi i profilit gjeometrik të sipërfaqeve | njësi | 24 | | | |
| 7 | | Ndërrimi i gominave hermetizuese dhe montimi i sektorëve unazor mbajtës | njësi | 20 | | | |
| | **KONTROLLI PËRFUNDIMTAR I PUNIMEVE** | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Kontrolli i zonave të salduara dhe profilit gjeometrik, realizimi i polerimit në të gjitha sipërfaqet e salduara | njësi | 96 | | |
| 2 | | Kontrolli me penetrat i të gjithë sipërfaqeve të rrotës së punës së punës dhe dokumentimi me fotografi | njësi | 96 | | |
| 3 | | Demontimi i platformës nën rrotën e punës dhe dorëzimi i punimeve objektit | njësi | 2 | | |
| **SHUMA** | | | | | | |
| **FONDI REZERVE** | | | | | | |
| **SHUMA** | | | | | | |
| **TVSH** | | | | | | |
| **SHUMA TOTALE** | | | | | | |

**PREVENTIVI PUNIMEVE**
**RIPARIMI I DËMTIMEVE NË RROTËN E PUNËS, TUBACIONET E PRISHJES SË VAKUMIT NË TUBIN THITHËS TË 5 (PESË) AGREGATEVE NË HIDROCENTRALIN E VAU I DEJËS.**

| NR. | NR. ANALIZE | PËRSHKRIMI I PUNËVE | NJËSIA | SASIA E PRITSHME | ÇMIMI NJESI | ÇMIMI TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **PUNIME PËRGATITORE** | | | | | |
| 1 | | Ndërtimi skele druri poshtë rrotës së punës, kompletimi me shkalle dhe rrethim mbrojtës | m2 | 15.1 | | |
| 2 | | Transporti në galeri në kuotë 13.5 m të pajisjeve dhe veglave të punës. Instalimi i panelit të ushqimit dhe instalimi i pajisjeve të saldimit në galeri. Instalimi i pajisjeve të furnizimit me ajër, furrës tharëse dhe pajisjeve të axhustimit në platformë. Kompletimi me ndriçim i dhomës spirale, platformës dhe bankoportave hyrëse. Marrja e masave të sigurimit teknik në dhomën spirale, rrotën e punës dhe tubin thithës | njësi | 5 | | |
| | **PUNIME TEK LOPATAT E RROTES SË PUNËS** | | | | | |
| 1 | | Kontrolli me penetrant për përcaktimni e dëmtimeve tek lopatat e rrotës së punës | njësi | 20 | | |
| 2 | | Axhustimi i zonave të dëmtuara, kontrolli me penetrat dhe përgatitja për saldim | njësi | 20 | | |
| 3 | | Realizimi i proçesit të saldimit dhe kontrolli në mënyrë të vazhduar me penetrant | njësi | 20 | | |
| 4 | | Axhustimi i zonave të salduara dhe realizimi i profilit gjeometrik | njësi | 20 | | |
| | **PUNIME NË ZONAT E KAVITUARA NË MES LOPATAVE NE UNAZËN E SIPËRME** | | | | | |
| 1 | | Përcaktimi me matje i përmasave të kavituara tek secila lopatë | njësi | 30 | | |
| 2 | | Pastrimi me elektroda karboni i zonave të dëmtuara duke bërë kontroll me penetrant | njësi | 30 | | |
| 3 | | Axhustimi i zonave të pastruara dhe përgatitja për saldim | njësi | 30 | | |

**Shtojca 15**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | | Realizimi i proçesit të saldimit duke bërë kontroll me penetrant | njësi | 30 | | |
| 5 | | Axhustimi i sipërfaqeve te salduara dhe realizimi i profilit gjeometrik të sipërfaqeve | njësi | 30 | | |
| | **PUNIME NË ZONAT E HYRJES DHE DALJES SË LOPATAVE TEK UNAZA E POSHTME** | | | | | |
| 1 | | Përcaktimi me matje i përmasave të kavituara tek secila lopatë | njësi | 50 | | |
| 2 | | Pastrimi me elektroda karboni i zonave të dëmtuara duke bere kontroll me penetrant | njësi | 50 | | |
| 3 | | Axhustimi i zonave të pastruara dhe përgatitja për saldim | njësi | 50 | | |
| 4 | | Realizimi i proçesit të saldimit duke bërë kontroll me penetrant | njësi | 50 | | |
| 5 | | Axhustimi i sipërfaqeve të salduara dhe realizimi i profilit gjeometrik të sipërfaqeve | njësi | 50 | | |
| | **PUNIME NE TUBACIONET E PRISHJES SË VAKUMIT DHE NË ZONAT E KAVITUARA NË TUBIN THITHËS** | | | | | |
| 1 | | Demontimi i sektorëve unazor të dëmtuara tek kolektori | njësi | 10 | | |
| 2 | | Matja dhe përcaktimi i përmasave të kavituara në tubin thithës | njësi | 10 | | |
| 3 | | Pastrimi i zonave të dëmtuara në tubin thithës dhe kontrolli me penetrant | njësi | 10 | | |
| 4 | | Realizimi i proçesit të saldim në tubin thithës, kontrolli me penetrant | njësi | 10 | | |
| 5 | | Axhustimi i zonave të salduara dhe kontrolli me penetrant | njësi | 10 | | |
| 6 | | Montimi i tubacionit në sektorin unazor dhe elementëve mbështetës, realizimi i proçesit të saldimit, kontrolli me penetrant | njësi | 10 | | |
| 7 | | Axhustimi i sipërfaqeve të salduara dhe realizimi i profilit gjeometrik të të gjithë zonës | njësi | 10 | | |
| | **KONTROLLI PËRFUNDIMTAR I PUNIMEVE** | | | | | |
| 1 | | Kontrolli i zonave të salduara dhe profilit gjeometrik, realizimi i polerimit në të gjitha sipërfaqet e salduara | njësi | 110 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | | Kontrolli me penetrat i të gjithë sipërfaqeve të rrotës së punës së punës dhe dokumentimi me fotografi | njësi | 110 | | |
| 3 | | Demontimi i platformës nën rrotën e punës dhe dorëzimi i punimeve objektit | njësi | 5 | | |
| **SHUMA** | | | | | | |
| **FONDI REZERVE** | | | | | | |
| **SHUMA** | | | | | | |
| **TVSH** | | | | | | |
| **SHUMA TOTALE** | | | | | | |

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR**[4]

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:
____________________________________________________________________________
____________________________________________________________________________
____________________________________________________________________________
___________________________________________________________________________

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

[4] Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
**< Emri >**

**Shtojca 16**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data________]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët □ oferta ekonomikisht më e favorshme □

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera _______________________________

*(me numra dhe fjalë)*

2.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ____________________________

*(me numra dhe fjalë)*

Etj.______________________________

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

_______________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____________________________

Ankesa: ka ose jo______________

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ___________________________

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 17**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*
1. ______________________________________
*2.* ______________________________________
*3.*______________________________________

* * *

Procedura e prokurimit: ______________________
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: □ oferta ekonomikisht më e favorshme □çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1.________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ______________________________
*(me numra dhe fjalë)*

2.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ______________________________
*(me numra dhe fjalë)*

Etj.____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _______________/ Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*

2.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera ___________/Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*

Etj.__

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ____________________________

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 18**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS**
**Punët – Procedura e Hapur**

**Neni 1: Qëllimi**

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruara ne bazë të legjislacionit të prokurimit.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.

1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.

2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.

2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

2.9 “Data e fillimit” eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakton punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.

2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

2.18 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

2.19 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

2.20 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

2.21 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2.22 "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të sherbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 5: Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar qe nënkontraktorin të zbatojë

punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Prona Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7: Origjina e Materialeve**

7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

**Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

**Neni 9: Komunikimi**

9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

**Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit te punimeve.

**Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshe qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes se Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 17: Zbulimet**

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen per te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhezimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

**Neni 18: Disponimi i Kantierit**

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

**Neni: 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduara rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

**Neni 20: Paralajmërimi në Kohë**

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

**Neni 21: Kontrolli i Cilësisë**

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t’i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

**Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara**

22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

**Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontrakotr**

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit te Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

(a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/ kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.

(b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në ate masë qe lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

**Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit**

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

**Neni 25: Sigurimi**

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes ne kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anulluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

**Neni 26: Testimet dhe Inspektimet**

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose pregatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

**Neni 27 Garancitë**

27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

**Neni 28: Çmimi i Kontratës**

28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

**Neni 29: Kushtet e Pagesës**

29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhen siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratës, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqese nje deklarate me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është permbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.

29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t’i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

**Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës**

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

**Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës

**Neni 32: Forca Madhore**

32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

32.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

33.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti

Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

**Neni 34: Dëmet e Likujdueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve**

34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

**Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet**

35.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 36: Ndryshimi i Porosisë**

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
b) Korrigjime në materiale
c) Korrigjime në sasi

36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

36.5 Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 35 te ketyre kushteve te pergjithshme.

**Neni 37: Preventivi për Njësi ose në Total**

37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njësi nëse është një kontratë me çmim njësie. Nëse është një kontratë me çmim njësie, preventivi për njësi do të përmbajë volumet e zërave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

37.2 Preventivi për Njësi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

**Neni 38: Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve**

38.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhezime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

**Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim**

39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,

b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

**Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

40.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

**Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuara dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 42: Nënkontraktimi**

42.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

42.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësine e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

42.3 Cdo nenkontraktor duhet te kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkete tek nënkontraktori për punët që do të kryejë

42.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 43: Transferimi i të Drejtave**

43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 44: Sigurimi i Kontrates**

44.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

44.2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t’i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

44.3 Sigurimi i kontrates do t’i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës sëmarrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

**Neni 45: Baza Ligjore**

45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 46: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

46.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 47: Përfaqsimi i Palëve**

47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

**Neni 48: Lajmërimet**

48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 49: Llogaritja e Afateve**

49.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

**Shtojca 19**
[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**KUSHTET E VEÇANTA**
**Punët – Procedura e Hapur**

Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

**Neni 1: Përkufizime**

1.1 Autoriteti Kontraktor është ______________________________

1.2 Kontraktori është ______________________________

**Neni 2: Sigurimi i Kontrates**

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm:______________________________
______________________________
______________________________

**Neni 3: Drejtuesi i Projektit**

3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: ______________________________

3.2 Adresa/pika e kontaktit:______________________________

**Neni 4: Kantieri**

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i venddodhjes së objektit që do të realizohet):
______________________________
______________________________

**Neni 5 Data e Fillimit**

5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier më: ______________________________
______________________________

**Neni 6: Siguracioni**

6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:

a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: ___________________________
b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve: ___________________________________
c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: ____
d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier: ________________________

## Neni 7: Inspektimet dhe Testimet

7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: _________
_______________________________________________________________________________
_______________________________________________________________________________
_______________________________________________________________________________

## Neni 8: Lloji i Kontratës

8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një

- ❑ Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
- ❑ Kontratë me Shumë Totale

## Neni 9: Grafiku i Pagesës

9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: ________________________________
_______________________________________________________________________

9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda __________ ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

9.3 Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

## Neni 10. Pagesa Paraprake

10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

10.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

10.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet kontraktorit sipas formulës së mëposhtme: ___________________________________________________________
_______________________________________________________________________________

## Neni 11. Shërbimet në Lidhje me to

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

**Neni 12. Zbritja e garancisë së kontratës**

12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

____________________________________________________________________

__________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**Shtojca 20**

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]
[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

*[Data__________]*

Për : *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*
Në emer të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit *(nëse zbatohet)*: *[lloji i procedurës)*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: (*objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimit Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata, ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 21**

**FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR**

***Ankesë drejtuar :*** ***Autoriteti Kontraktor*** ☐

**Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërish).*

______________________________________________

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

______________________________________________

Adresa

| | | |
|---|---|---|
| ____________ | ____________ | ____________ |
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar/Kodi Zip |

| | |
|---|---|
| ____________ | ____________ |
| Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) |

______________________________________________

E-mail

______________________________________________

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

| | |
|---|---|
| ____________ | ____________ |
| Firma e zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |
| ____________ | ____________ |
| Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës) |

**Seksioni II. Informacion për Procedurën**

**1. Numër Identifikimi**
*Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë* ***llojin e procedurës së përdorur*** *për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

________________________________________________

**2. Autoriteti Kontraktor**
*Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

________________________________________________

**3. Vlera e Përllogaritur e Prokurimit**
*Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)*

________________________________________________

**4. Objekti i Kontratës**
*Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.*

________________________________________________

**5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës**
*Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.*

________________________________________________
Data (viti/muaji/dita)

**6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese**

________________________________________________
Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

**1. Baza Ligjore e Ankesës**
(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

________________________________________________

**2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve**

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*

**3. Lista e Shtojcave**

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë.*

*Mundësisht bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht* ***çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj.*** *Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

**Nr. Faks:**
**E-mail:**
**Nënshkrimi dhe Vula e Ankuesit**

**Shtojca 22**

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR**
( KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
**PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

[Përdorimi i ketij draft marreveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të perdorin marrëveshjen kuadër)

**Nr __**

**DATA:**

Kjo kontratë lidhet më [*data*], midis [*emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor*] tani e tutje të referuar si “Autoriteti Kontraktor” dhe [*emri dhe adresa e Kontraktuesit*] të përfaqësuar nga [*përfaqësuesi*], tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi”.

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [*data*] bie dakord të realizoje punimet, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë kontrate
- Formularin e Deklarimit te Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formularin e çmimit të ofertës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i marrëveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/shërbimeve/punëve në vijim.

[përshkrimi i përgjithshëm]

1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marreveshje.

1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara

1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe nuk do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër:

________________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra/shërbime janë treguar në Formularin e Çmimit të Ofertës.

2.2 Çmimet e njësive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marreveshje kuadër.

**Nënshkrimet dhe Datat**

| **Për Kontraktuesin** | | **Për Autoritetin Kontraktues** | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shtojca 23**

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR**

**( KU JO TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)**
**PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

**Emri i Autoritetit Kontraktues,**

Dhe

**Emri i Kontraktuesit**

Bien dakord si vijon:

**Të nenshkruajnë këtë marrëveshje kuadër për objektin** < vendosni titullin > me numrin identifikues : *<vendosni Numrin e Prokurimit>*

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i kësaj marrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të mini-konkurrencës vetëm ndermjet operatorëve ekonomike që janë palë e kesaj marrëveshje kuadër.

1.2 Kjo marrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

1.3 Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Paleve**

2.1 Autoriteti Kontraktues, palë në këtë marreveshje, do t’i dërgojë kontraktuesit “Ftesën për Oferte” kurdo që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdoherë që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër**

3.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkursit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkursit**

4.1 Procesi i mini-konkursit do të kryhet me të gjithë operatoret ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për punë /mallra/shërbime për Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do të ri-hapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë /mall /shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Ofertë dhe t’ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.

**Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër**

___________________________________

**Nënshkrimet dhe datat**

| **Për Kontraktorin** | | **Për Autoritetin Kontraktues** | |
|---|---|---|---|
| **Emri :** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shtojca 24**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR**

**Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor**

**1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________

Adresa ______________________________

Tel/Fax ______________________________

E-mail ______________________________

Faqja e Internetit ______________________________

**1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

Institucion Qëndror ☐ Institucion i Pavarur ☐

Njesi e Qeverisjes Vendore ☐ Tjetër ☐

**Seksioni 2 Objekti i Kontratës**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit**______________________________

**2.2 Lloji i "Kontratave për punë publike"**

Realizimi i punëve ☐ Projektimi dhe realizimi i punëve ☐

**2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po ☐ Jo ☐

**Nëse Po, lloji i Marreveshjes Kuadër**

**Me 1 Operator Ekonomik** 

**Me disa operatorë ekonomikë** 

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara**

Po  Jo 

**2.4 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

1 Fondi limit ________________________________________

2. Burimi i Financimit __________________________________

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër ___________________________________

**2. 5 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në **muaj**  **ose ditë** 

ose

duke filluar nga / / me përfundim në / /

**2.6 Ndarja në LOTE:**

Po  Jo 

*Nëse Po*, numri i LOTEVE*:* 

**2.7 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka): 

ose: nga  në  

**2.8 Kontrate me nenkontraktim:**

Po  Jo 

**Seksioni 3 Procedura**

**3.1 Lloji i procedurës:**

E hapur
□

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) **çmimi më i ulët** □

*ose*

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme** □

lidhur me rëndësinë: Çmimi □□ **pikë**□
etj. □□ **pikë**

**3.3 Numri i ofertave të dorëzuara:** □□□

**Numri i ofertave të rregullta:** □□□

**3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushen e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqërise së Informacionit:**

Po □ Jo □

**3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të paaplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit**

Po □ Jo □

**Seksioni 4 Informacion mbi kontratën**

**4.1 Numri i Kontratës: _______________Data e Kontratës** □□/□□/□□□□

**4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri ______________________________
Adresa ______________________________
Tel/Fax ______________________________
E-mail ______________________________
Faqja e Internetit ______________________________

4.2.1 **Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve**

Emri ______________________________
Adresa ______________________________
Tel/Fax ______________________________
E-mail ______________________________
Faqja e Internetit ______________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha __________
Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha __________

**4.3.1 Vlera totale e nenkontraktimit : ____**

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha __________
Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha __________

**4.4 Informacione shtesë**

________________________________________________________________

______________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi □□/□□/□□□□

**Shtojca 25**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Fax ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Faqja në Internet ____________________________________________

**2. Lloji i procedurës: ____________________________________________**

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër________________________**

**4.Numri i referencës së procedurës/lotit______________________________**

**5. Fondi limit ____________________________________________**

**6. Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

*Vlera ________________me Tvsh* *Monedha ________________________________*

*Vlera e nenkontaktimit________________me Tvsh* *Monedha _____________________*

**7. Data e lidhjes së kontratës ____________**

**8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktimit**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Nr. NIPT ____________________________________________

**Shtojca 26**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE ANULIMIT**

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Faqja në Internet ______________________________________________

**1. Lloji i procedurës:** ________________________________________

**2. Numri i Referencës:** ________________

**3. Objekti i kontratës** ________________________

**4. Fondi limit** ____________________________________________

**5. Arsyet e Anulimit:**

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 24, pika 1: **a)** ;
**b)** ;
**c)** ;
**ç)** ;
**d)** ;
**dh)** ;

**Etj.** ________________________________________

**6. Informacione shtesë**

_____________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi